

POLITIKAT E PRIVATËSISË

Mbrojtja e privatësisë suaj gjatë përdorimit apo vizitës në këtë platformë është me rëndësi të madhe për ne. Prandaj ne kemi kënaqësinë t'ju informojmë se si përpunohen të dhënat personale.

Platforma **www.punesohu.albigroup.com** është pronë e **ALBI GROUP**.

ALBI GROUP është grupi i kompanive që ushtron aktivitete të ndryshme tregtare si: **Albi Commerce SH.P.K.**, (*distribuimi i produkteve dhe qendra tregtare ALBI MALL*), **Albi Fashion SH.P.K.**, **Albi Fashion Retail SH.P.K.**, **Jaroma Fashion SH.P.K.**, **N.A.N SH.P.K.**, **OBE SH.P.K.**, **D.D&O SH.P.K.**, **Ardi Co SH.P.K.**, me aktivitet kryesor tregtia me pakicë e tekstilit, **Albi Shopping SH.P.K.**, (që ka si aktivitet rrjetin e marketeve **ALBI MARKET**, tutje referuar kompanitë si “**ALBI**”, dhe është përgjegjës për privatësinë e të dhënave në këtë faqe interneti.

Albi i përmbahet rreptësisht rregullave të aplikueshme të mbrojtjes së të dhënave, gjatë përdorimit dhe përpunimit të të dhënave personale. Albi rezervon të drejtën e përdorimit të të dhënave personale dhe anonime në masën e lejuar me ligj, në varësi të të drejtave të personave të prekur siç përshkruhet më poshtë.

Kjo politikë e privatësisë është e vlefshme vetëm për **www.punesohu.albigroup.com** dhe jo për faqet e internetit që ndërlidhen me platformën tonë dhe që menaxhohen dhe operohen nga palë të treta. Gjatë përdorimit të platformës tonë për aplikim për punë mund të lidheni me faqe tjera interneti të operuara nga palët e treta. Me rastin e transferimit në faqe tjetër interneti, ju duhet të informoheni lidhur me politikat e këtij operatori lidhur me menaxhimin e të dhënave tuaja personale. Ne nuk mbajmë asnjë përgjegjësi, në rast se ju përmes një linku, apo hiperlinku, apo formë tjetër lidheni me një faqe tjetër interneti.

Përkufizimet

E dhënë personale - çdo informacion në lidhje me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm (“subjekt i të dhënave”); një person fizik i identifikueshëm është ai, i cili, mund të identifikohet drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt, veçanërisht duke iu referuar një identifikuesi në bazë të një emri, një numri identifikimi, të dhënave rreth vendndodhjes, një identifikues online, ose një apo më shumë faktorë specifikë për identitetin fizik, psikologjik, gjenetik, mendor, ekonomik, kulturor ose social të atij personi fizik;

Përpunim - çdo veprim ose seri veprimesh që kryhen ndaj të dhënave personale me mjete automatike ose jo, si: mbledhja, regjistrimi, organizimi, strukturimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, tërheqja, konsultimi, përdorimi, publikimi nëpërmjet transmetimit, shpërndarja ose ofrimi, njësimi ose kombinimi, kufizimi, fshirja ose asgjësimi;

Pëlqim me shkrim i subjektit të të dhënave – pëlqimi i dhënë ku subjekti i të dhënave duhet të vë nënshkrimin ose shenjën në pëlqimin me shkrim për përpunimin e të dhënave të tij ose saj;

Pëlqim gojor ose pëlqim tjetër i përshtatshëm i subjektit të dhënave - pëlqimi i dhënë gojarisht, me anë të mjeteve të telekomunikimit ose me ndonjë mjet tjetër të përshtatshëm, përmes të cilit mund të konkludohet në mënyrë të qartë se subjekti i të dhënave e ka dhënë pëlqimin e tij ose saj;

Kontrollues i të dhënave - çdo person fizik ose juridik nga sektori publik ose privat që individualisht ose së bashku me të tjerët përcakton qëllimet dhe mënyrat e përpunimit të të dhënave personale;

Subjekt i të dhënave - nënkupton një person, të dhënat personale të të cilit përpunohen.

1. Privatësia e të dhënave

Mbrojtja e të dhënave personale dhe privatësia e individit është njëra nga përgjegjësitë tona thelbësore. Ne ndërmarrim masat e duhura teknike dhe organizative për të mbrojtur të dhënat tuaja nga humbja, manipulimi, rrjedhja e tyre jashtë ALBI ose aksesit i paautorizuar. Masat e marra i nënshtrohen rishikimit të rregullt dhe përshtaten vazhdimisht për të qëndruar teknologjikisht të azhurnuara.

2. Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave personale

Të gjitha të dhënat personale të grumbulluara nga vizitorët dhe përdoruesit e platformës **www.punesohu.albigroup.com** trajtohen në përputhje me Ligji Nr. 06/L-82 për mbrojtjen e të dhënave personale.

ALBI Group përpunon dhe menaxhon të dhënat personale në kuptim të nenit 5 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pra vetëm nëse ju si subjekt i të dhënave personale jepni pëlqimin tuaj për përpunimin dhe menaxhimin e tyre nga ana jonë.

Të dhënat tuaja personale do të përpunohen për qëllimet e përshkruara më poshtë (shih pika **IV**).

3. Të dhënat personale të mbledhura:

Të dhënat tuaja personale të cilat ne mund t'i mbledhim përfshijnë informatat si në vijim:

- Informatat identifikuese të tilla si: emri dhe mbiemri, ,adresa, numri i telefonit, email adresa, kur ju aplikoni për një vend të punës.
- Me rastin e verifikimit të identitetit, ne mund të përpunojmë edhe numrin e dokumentit të identifikimit.
- Në disa raste, kur ju përdorni shërbimet tona, ju mund të ofroni informata personale siç mund të jenë: mosha, gjinia, interesat, eksperiencia, edukimi .
- Informata shtesë që kërkohen apo autorizohen nga ligjet e aplikueshme për të mbledhur dhe për të procesuar me qëllim identifikimi dhe verifikimi të informacionit që kemi mbledhur nga ju.

4. Qëllimi i mbledhjes së të dhënave

Ne i përpunojmë të dhënat personale të përmendura në pikën **III** për qëllimet e mëposhtme:

- Kur aplikoni për punë përmes faqes tonë vetëm për qëllim të shqyrtimit të aplikacionit tuaj për punësim.
- Autentifikimin tuaj për qasje të sigurt në shërbime tona;
- Për t'ju kontaktuar në lidhje me aplikimin për punë.

Nuk i përdorim përsëri të dhënat tuaja për një qëllim tjetër që është i ndryshëm nga ai i deklaruar.

Si rregull, ne nuk i mbajmë të dhënat tuaja personale për më gjatë se sa është e nevojshme për qëllimet për të cilat i kemi mbledhur ato. Ne mund t'i mbajmë të dhënat tuaja personale për një periudhë më të gjatë për qëllime historike ose statistikore me masa mbrojtëse të përshtatshme.

5. Të drejtat tuaja

Ju keni të drejta të bazuara në Sipas Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale kur bëhet fjalë për përpunimin e të dhënave tuaja personale nga ALBI .

Kur të dhënat tuaja personale përpunohen nga ALBI, ju keni disa të drejta të garantuara me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale si:

E drejta juaj për qasje në të dhënat personale- Ju keni të drejtë të kërkonti nga ne të keni qasje në të dhënat e juaja personale nëse përpunohen ose jo.

E drejta juaj për korrigjim të të dhënave personale- Ju keni të drejtë të keni qasje në të dhënat tuaja dhe në çdo kohë, të kërkonti t'i korrigjoni nëse mendoni se të dhënat janë të pasakta dhe përditësoni ato pa vonesë nëse mendoni se të dhënat tuaja janë jo të plota. Ju mund të kërkonti që ndonjë nga ndryshimet e mësipërme t'u komunikohet palëve të tjera, të cilave u janë zbuluar.

E drejta “për tu harruar”- Ju keni të drejtë të fshirjes (‘e drejta për t’u harruar) së të dhënave tuaja dhe mund të kërkonti që përpunimi të ndalohet në rrethana të caktuara.

E drejta juaj për të kundërshtuar- Ju keni të drejtë të kundërshtoni përpunimin e të dhënave personale nga ana jonë , në rrethana të caktuara, për arsye që lidhen me situatën tuaj specifike. Albi pas kundërshtimit tuaj nuk vazhdon me përpunimin e të dhënave personale, përveç rasteve të cilat i parasheh ligji për përpunimin e tyre lidhur me rrethanat të cilat mbizotërojnë mbi interesat, të drejtat dhe liritë e subjektit të të dhënave.

E drejta juaj për ankesë tek Agjencia për Informim dhe Privatësi- Ju keni të drejtë të ankoheni në çdo kohë nëse besoni se të drejtat tuaja për mbrojtjen e të dhënave janë shkelur, apo në qoftë se mendoni se ALBI nuk është duke respektuar dispozitat ligjore të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

6. Sugjerimet dhe Ankesat

Nëse ju keni ndonjë pyetje, sugjerim apo ankesë për këtë Politikë të Privatësisë, apo në lidhje me të drejtën tuaj të privatësisë dhe mbrojtjen e të dhënave tuaja personale ju mund të na kontaktoni përmes e-mailit në hr@albicenter.com

7. Ndryshimet në këtë Politikë të Privatësisë

Nëse bëjmë ndryshime në këtë politikë, që sipas vlerësimit tonë është me peshë do t'ju njoftojmë përmes platformës apo email-it. Cila do mënyrë që do të përdoret për njoftime të tilla, cilësohet si zyrtare. Duke vazhduar t'i vizitoni apo përdorni shërbimet pasi që këto ndryshime të hyjnë në fuqi, konsideroheni se ju pajtoheni plotësisht me përditësimet e bëra.



Veternik, Zona e re industriale 10000, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 (0) 38 500 202 100, Fax: +383 (0) 38 500 202 550
www.albigroup.com

